



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI.

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 14.

Prishtinë, më 06.03.2018 në ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Milaim Zeka, Fikrim Damka, Fitore Pacolli dhe Adem Hoxha.

Munguan: Fatmire Kollçaku dhe Glauk Konjufca.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësuesi nga GIZ, OSBE, NDI, KDI, Zyra e BE-së dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare e komisionit

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e komisionit me këtë

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 02.02.2018 dhe 14.02.2018;**
- 3. Raportim i z. Mahir Yagcilar, ministër i Administratës Publike, lidhur me përmbushjen e obligimeve, në kuadër të agjendës evropiane;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me**

Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 02.02.2018 dhe 14.02.2018;

Procesverbalet e mbledhjeve të dt. 02.02.2018 dhe 14.02.2018 u miratuan pa vërejtje.

3. Raportim i z. Mahir Yagcilar, ministër i Administratës Publike, lidhur me përmbushjen e obligimeve në kuadër të agjendës evropiane;

Kryetarja, falënderoi ministrin që iu ka përgjigjur ftesës, për të raportuar para komisionit dhe tha se duke pas parasysh se reforma në administratën publike edhe më tutje mbetet si njëra ndër kushtet kryesore sa i përket agjendës evropiane, ju kemi ftuar të raportoni për përmbushjen e veprimeve që i keni marrë, në këtë drejtim, si ministri.

Bazuar në Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së, si dhe në agjendën për reformë evropiane, ministria që ju e drejtoni, ka planifikuar që një pjesë e masave që lidhen kryesisht me reformën e administratës publike, t'i përfundojë vitin e kaluar, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Pra, ka pasur vonesa në këtë drejtim, andaj a mund të na tregoni pse kanë ndodhur këto vonesa? Po ashtu, edhe çështja e pagave, si një çështje shumë e përfolur në kohën e fundit, sepse në çdo takim që e kemi pasur me zyrtarët e BE-së, na është kërkuar që Ligji për pagat, të silllet në Kuvend. Kur do të bëhet kategorizimi i pagave të zyrtarëve të lartë dhe kur do të silllet në Kuvend?

Ministri Mahir Yagcilar, falënderoi për ftesën dhe fillimisht tha se administrata publike nuk është në direktivat e integritimeve evropiane, por kërkohet që të jetë një administratë e përgatitur dhe të zbatojë të gjitha objektivat dhe është pjesë thelbësore e procesit të shtetndërtimit. Në këtë aspekt, për të realizuar këto objektiva dhe për t'i zbatuar disa pika që janë të lidhura me MSA-në, në vitin 2012-2013, është formuar grupi i veçantë për reforma në administratën publike, i cili mbahet 2 herë në vit me Komisionin Evropian, për t'i përcjellë zhvillimet në administratën publike. Nga ana tjetër, MAP, gjithashtu, me ministrinë tjera ka hartuar strategjinë e nevojshme për modernizimin e administratës publike dhe pjesë tjera. Çdo shtet që synon integritimin në BE duhet të miratojë strategjitë e nevojshme në përputhje me disa parime, siç janë: Korniza strategjike, kur kërkohet edhe mbikëqyrja politike, dhe në këtë aspekt, formuam Këshillin Ndërmintor për reforma të administratës publike, i cili zhvillon takime me grupin e veçantë për reforma të administratës publike. Koordinimi dhe zhvillimi i politikave që është përgjegjëse Zyra e Kryeministrit, për të cilën ekziston Strategjia për rregullimin dhe koordinimin e politikave, ndërsa MAP është përgjegjëse edhe për 3 parime

tjera, si shërbimi civil dhe ofrimi i shërbimeve, llogaridhënia dhe menaxhimi burimeve njerëzore, ndërsa Ministria e Financave është përgjegjëse për fushën e menaxhimit të financave publike.

Ndërsa, nga aspekti i MSA-së, administrata publike nuk është e përfshirë drejtpërdrejt në direktiva dhe është kërkuar të jetë pjesë në organizimin më të mirë të administratës publike, dhe në këtë aspekt, kërkohet të miratohet Ligji për administratën publike. Sipas agjendës, MAP ka propozuar në Qeveri koncept-dokumentin për organizimin e administratës publike dhe tash jemi duke punuar në projektligj dhe presim që në qershor të procedohet ligji në Kuvend.

Gjithashtu, për Ligjin për shërbyesit civilë, koncept-dokumenti është miratuar vitin e kaluar në Qeveri dhe tani është duke u punuar në ligj dhe pritet të procedohet para muajit qershor.

Kurse, sa i përket ligjit për pagat nga buxheti i Republikës së Kosovës, ka pasur kërkesa që të procedohet sa më shpejt, por ka qenë kërkesë e Komisionit Evropian që 3 ligjet të shkojnë në pako dhe ne kemi hartuar koncept-dokumentin dhe presim që të premtën të miratohet në Qeveri.

Në MSA dhe agjendën evropiane, MAP ka edhe një çështje, në aspektin e parimit të llogaridhënies, faktikisht rishikimit i agjencive të ndryshme dhe roli nga aspekti i statusit. Lidhur me këtë, është kërkuar që të bëhet një memorandum bashkëpunimi mes Qeverisë dhe Kuvendit, për të rishikuar disa agjenci, të cilat kanë rolin ekzekutiv, të kalohen prej Kuvendit, në ekzekutiv dhe të krijohet një vijë e qartë, sa i përket llogaridhënies për të gjithë në administratën publike, pavarësisht se çfarë statusi kanë.

Nga aspekti i parimit të zbatimit të reformave në administratën publike, ne e kemi obligim të zbatojmë planin e veprimit për modernizimin e administratës publike dhe SIGMA është duke e monitoruar zbatimin e strategjisë dhe më 20 mars do ta kemi publikimin e raportit lidhur me gjendjen dhe krahasimet me shtetet tjera, në realizimin e këtyre fushave.

Ilir Deda, tha se sa e ka kuptuar nga raporti, që ka vazhduar procesi i klasifikimit të vendeve të punës në grada përkatëse, sipas katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil.

Para se të vijë Ligji për paga, a duhet të jetë i përfunduar ky proces, i cili ka filluar që në mandatin e kaluar, nëse po, atëherë kur mendoni se do të përfundojë ky unifikim i titujve, një pagë për një punë të njëjtë?

Për t'u bërë i mirë Ligji për pagat, do të jetë më i komplikuar se si paraqitet në opinion publik. Ky ligj është shumë i rëndësishëm, sepse ne kemi mospërputhje të mëdha të pagave në nivelin lokal dhe qendror dhe duhet të ketë avancim të nivelit komunal. Ky komision nuk ka marrë pjesë as në konsultime për këto ligje të rëndësishme, kurse ne jemi komision primar, sepse ka të bëjë direkt me agjendën evropiane të reformave, andaj sugjeroj që të ketë kyçje më të madhe të komisioneve të Kuvendit, që ky ligj të bëhet sa më mirë.

Kryetarja, pajtohet me z. Deda, lidhur me pagat e nivelit lokal, sepse tha se e dimë sa të padinjitetshme janë pagat, sidomos të zgjedhurve nga populli dhe është një diskrepancë e madhe mes nivelit qendror dhe lokal dhe do të ishte mirë që ky komision të përfshihet në draftimin

dhe katalogimin e këtyre shërbyesve, sepse është pjesë e agjendës që ne e kemi ndjekur dhe jemi të interesuar që sa më shpejt të vijë ligji në Kuvend dhe të jetë i plotë dhe i definuar.

Ministri, sqaroi se është fjala për dy çështje, së pari, tha se Ligji për pagat bëhet për të gjithë përfituesit nga buxheti i Republikës së Kosovës, duke filluar prej pozitës së Presidentit e deri te pozita më e ulët. Ligji do të jetë i unifikuar dhe me kalimin e koncept-dokumentit do të kalojmë prapë të punojmë, sepse kemi shumë të dhëna .

Ndërsa, katalogu i punës, sipas ligjit, është për nëpunësit civilë, por i cili në aspektin financiar kur nuk është zbatuar, sepse atëherë ka qenë një prej kushteve të nënshkrimit të MSA-së, ku është dashur të miratohet Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës dhe katalogu i vendeve të punës. Por, pse nuk janë përfshirë të gjitha pozitat në këtë katalog? Ka ende nga aspekti i llogaridhënies, por edhe nga aspekti i vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese, sa i përket qarkores që e kemi lëshuar për katalogimin e vendeve të punës, dhe një pjesë e administratës publike nuk i ka dërguar të gjitha dhënat, sa i përket katalogut të vendeve të punës.

Ilir Deda, pyeti se në koncept-dokumentin për pagat e shërbyesve civilë a ekziston ndarja, si shërbimi i jashtëm, FSK-ja, etj, çka do të thotë se Ministria e Jashtme nuk mund të jetë në një rang me ministrinë tjera, a është edhe kjo pjesë apo është një avaz që ka mbetur prej UNMIK-ut, një standard për të gjithë?

Ministri, theksoi se edhe deri më tani nuk ka qenë njëjtë, që edhe në këtë moment, në listën e pagave janë sisteme të ndryshme, por me miratimin e koncept-dokumentit, pastaj do të zhvillohen edhe këto diskutime dhe debate në fusha të ndryshme. Ne do ta bëjmë një tabelë të përbashkët, por çdo vend pune do ta ketë një koeficient, i cili do të vlerësohet dhe neve na duhet një përkrahje e të gjithëve, në mënyrë që ta bëjmë raportimin sa më të drejtë për të gjitha pozitat, duke e përfshirë edhe nivelin komunal.

Zenun Pajaziti, pyeti ministrin: A kishe mundur t'i listosh disa çështje kryesore që mendoni ju që janë sfida për mospërmbyesjen e obligimeve tona; proceset integruese dhe a e ke mbështetjen e mjaftueshme, si ministër, nga Qeveria dhe resorët tjerë, për t'i adresuar brenda vështirësitë që janë te dikasteret e caktuara, pse kemi ende sfida? Po ashtu, mundësisht, të na adresoni edhe neve, çka kemi mundësi si Kuvend i Kosovës për të bërë më shpejt, në mënyrë që çështjet që janë sfida në resorin tuaj, që ju i listoni si sfida ende dhe që kanë të bëjnë qoftë me reformën, qoftë me modernizimin e shërbimit, pra diçka që ne kishim mundur sa më shpejt në ato pjesë të kontribuojmë më shumë.

Armend Zemaj, theksoi se ajo që duhet të ishte shqetësuese për juve si ministri dhe për Kuvendin e Kosovës, është stërzgjatja e këtij procesi dhe këtyre reformave. E them këtë, sepse shkoi viti 2017 dhe kemi hyrë në vitin 2018, dhe me këtë dinamikë siç e përshkruat ju, nuk besoj që as në qershor nuk do të kemi miratimin e këtyre ligjeve, përndryshe dy-tri aspektet që ju i përmendet, janë më se të nevojshme që ne t'i kanalizojmë në një drejtim, për të cilin Kosova nuk po mund t'u japë udhën, jo vetëm tani, por as në qeveritë e kaluara.

Konfuzioni që është dhe dualizmi nëpër institucione, sidomos te agjencitë e pavarura dhe njësisve të tyre përbërëse dhe pjesa tjetër që lidhet me paga, si dhe raporti juaj me Ministrinë e Financave, sepse ju jeni përgjegjës për ofrimin e shërbimeve publike dhe shërbimin civil, ndërsa pjesa tjetër që lidhet me menaxhimin e financave i takon Ministrisë së Financave.

Kurse, te pjesët e tjera që lidhen me katalogun e pagave, tha se ne e dimë që në Kuvend ka ardhur në fund të legjislaturës së kaluar, ka pasur interferime se në bazë të interesave, kush punon në atë katalog të pagave dhe ka pasur një dualizëm mes peshës institucionale, atyre që e bëjnë një punë të caktuar dhe pjesëve tjera, ashtu siç është ligji për protokollin, sot, që është njëri prej ligjeve më të çuditshëm në rajon dhe në Evropë. E kam parë koncept-dokumentin dhe ngërthen në vete krejt çka po e flasim ne dhe ambiciet e krejt Kosovës, duke marrë parasysh kushtet dhe kriteret që i kemi përqaftuar edhe me MSA-në dhe agjendën e reformave evropiane, por do të ishte më mirë të informohemi drejtpërdrejt nga ju se cili do të ishte imputi ynë i presionit nga roli që e kemi si mbikëqyrës parlamentar ndaj institucioneve të caktuara. Në këtë rast, Qeverisë së Kosovës, që kjo të shtyhet përpara.

Fitore Pacolli, tha se ka disa pyetje për ministrin:

1. Ndikimi politik në emërimet, sidomos në pozita të larta të nëpunësve civilë, si dhe emërimet në borde publike, kjo mbetet shqetësuese, sepse ne po flasim për integrimet evropiane, nuk ka Raport të Progresit, të publikuar nga Komisioni Evropian, që nuk e paraqet situatën shqetësuese.

Andaj, çka ka bërë ministria apo çka ka në plan të bëjë ajo, në këtë drejtim?

2. Pyetja lidhet me rekrutimin e shërbyesve civilë, Raporti i Progresit i vitit 2016, ka theksuar se MAP nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për t'i mbikëqyrur në mënyrë aktive procedurat e rekrutimit, andaj a keni ndërmarrë diçka ne këtë drejtim, nëse po a mund të na informoni se çka?

3. A keni hartuar plan të veprimit për vitin 2018, të zbatimit të kontratës për reformë sektoriale, nëse e keni hartuar, a mund të na dërgoni në komision?

4. Strategjia për modernizimin e administratës publike, e cila përfshin vitin 2015-2020, kurse ju e keni pasur të hartuar planin e veprimit për vitin 2015-2017. A keni bërë plan të veprimit për vitin 2018? Nëse po, atëherë kërkoj që të na e dërgoni, në mënyrë që ta përcjellim punën e ministrisë.

Milaim Zeka, pyeti ministrin: Pse nuk është përfunduar deri më tani Ligji për pagat? Besoj se juve dhe krejt Qeverinë iu bën shumë të lumtur mosfunksionim i Kuvendit të Kosovës, dhe për këtë mosfunksionim, ju e keni gjetur luksin që mos të sillni ligje dhe ky vakum institucional po ia krijon Qeverisë luksin të shkarkojë një bord, pa konsulta paraprake, siç është Bordi për arsim, pa menduar paraprakisht se sa rëndë dëmtohet shteti i Kosovës, prandaj sa i përket reagimit të OJQ-ve në Kosovë, e kam thënë dhe po e ritheksoj publikisht se OJQ-të dhe shoqëria civile në Kosovë, janë për 20 herë më të korruptuar dhe në situatë më të keqe se sa Qeveria e Kosovës, kjo ia jep luksin Qeverisë dhe ministrave, sepse do të duhej të ishte problem zvarritja e një ligji për naftën, sepse atje preken interesat e biznesit, ndërsa që ne të jemi pa ligjin për pagat dhe mos të bëhet nivelimi i pagave, që të ketë administratorë

nëpër disa komuna, me rrogë 170 € që një gazetar nëpër portale paguhet 120€ dhe shumica prej tyre punojnë pa kontrata të punës dhe rroga mesatare e gazetarëve është 200€ Kjo është diskriminim, racizëm dhe shkelje e të drejtave të njeriut, në kohën kur ministrat, deputetët dhe institucionet e ndryshme bëjnë harxhime marramendëse nëpër dreka nëpër restorante, andaj mbi bazën e kësaj e kam vetëm këtë pyetje, pse nuk e keni sjellë ligjin deri më tani dhe trego se kush të ka penguar për miratimin e këtij ligji?

Në fund, tha se ju ministër e dini se bordet dhe agjencitë e pavarura janë mini qeveri, brenda Qeverisë.

Ministri, lidhur me pyetjen e deputetit Pajaziti, tha se një prej çështjeve më esenciale në Kosovë është moszbatimi i ligjit për pagat për shërbyesit civilë, i cili ka krijuar shumë probleme, si dhe mosekzistimi i ligjit bazik për paga dhe moszbatimi i duhur i dokumenteve strategjike dhe ligjeve na ka prurë në atë situatë, që të hartojmë një ligj unik për pagat për të gjithë përfituesit .

Administrata publike është një fushë pak më ndryshe dhe çdo institucion po mendon se duhet hyrë në kuadër të saj dhe ka vështirësi të zbatohen çështjet që miratohen nga aspekti i administratës publike. Nuk është puna vetëm e administratës publike, por e të gjitha institucioneve të administratës publike dhe ka pasur nevojë edhe për një përkrahje politike më të madhe. Me miratimin e këtij ligji, do të krijojmë një platformë që do të jetë edhe për menaxhimin e pagave dhe menaxhimin e burimeve njerëzore përbrenda.

Në vitet e kaluar nuk ka pasur buxhet të mjaftuar për reforma, sidomos para disa viteve Ligji për pagat e nëpunësve civilë është tërhequr, sepse ka pasur një kosto dhe kjo ka krijuar probleme.

Në vazhdim, tha se për herë të parë nga Komisioni Evropian kemi pasur përkrahje sektoriale buxhetore për administratën publike dhe nëse zbatohen të gjitha direktivat, indikatorët dhe objektivat nga strategjia, atëherë do të kemi përfitime dhe veç kemi filluar. Pra, sa i përket reformës së administratës publike kemi përfituar 24 milionë€ dhe do të vazhdohet me shumë më të madhe në menaxhimin e financave publike, i cili është në kuadër të reformave të administratës publike.

Sa i përket dualizmave mes institucioneve, tha se ka, por dualizëm ka shpesh edhe mes ligjeve dhe pastaj po krijohen këto probleme.

Kurse, lidhur me renditjen e pozitave në listën e pagave, do të bëhet një propozim, i cili do të bazohet në ligjet dhe protokollin e shtetit, si dhe përvojat e shteteve të ndryshme, por ne duhet të bazohemi edhe në situatën reale në Kosovë, por nëse ka mbivlerësim, atëherë duhet ta shikojmë renditjen, në listën e pagave, pozita e Presidentit nuk është e para, pozita e Kryeministrit është në pozitën e 85-të. Po ashtu, edhe pozita e deputetit është përafërsisht aty, kurse pozita e ministrit është në renditjen 110 dhe kjo nuk është e mirë. Prandaj, kur të përfundohet renditja sipas ligjeve që nuk e prishin balancën e funksionimit do ta sjellim në Kuvend dhe së bashku ta shikojmë se si mund ta rregullojmë, është me rëndësi, sepse do ta kemi një ligj bazik që do të rregullojë pagat.

Sa i përket pyetjes për ndikimin politik në emërimin në pozitat e larta, është e vërtetë se ka pasur vërejtje në raportet e progresit të Komisionit Evropian, por sipas ligjit ekzistues, si

ministër i MAP, jam përgjegjës të realizojë disa hapa, për të bërë emërimin e shërbyesve civilë në pozita të larta, e jo në borde, sepse aty nuk jam i përfshirë.

Mekanizimi nuk është ndoshta i përsosur, po ka funksionuar dhe ka nevojë që me ligjin e ri ta bëjmë ristrukturimin që ta minimizojmë ndikimin politik të emërimeve të larta të zyrtarëve drejtues. Rekrutimi shërbyesve civilë, po ashtu është një ndër problemet, por gjithashtu do të trajtohet në ligjin e ri për shërbyesit civilë.

Në vazhdim, tha se strategjia e modernizimit të administratës publike është 5 vjeçare dhe plani i veprimit është 3 vjeçar. Tani, veç e kemi përfunduar edhe planin e zbatimit për 2 vitet e ardhshme dhe mund ta procedojmë në komision për të parë se cilat janë ato ndryshime.

Në pyetjen se, pse deri më tani nuk është përfunduar Ligji për pagat, unë jam në mandatin e tretë, si ministër i MAP. Në mandatin e parë, kemi propozuar Ligjin për funksionarët publikë, por në leximin e parë nuk ka kaluar, sepse ka pasur mendime të ndryshme të deputetëve, kurse në mandatin e kaluar kemi pasur vështirësi, sepse Komisioni Evropian ka kërkuar që 3 ligjet të shkojnë së bashku në pako dhe për t'i mënjanuar problemet, kemi propozuar ligjin, i cili ka kaluar përmes Qeverisë, është proceduar në Kuvend, por duke u bazuar në reagimet e ndryshme, si nga Komisioni Evropian dhe obligimet që kemi marrë me agjendën evropiane, është tërhequr, ku është kërkuar që së pari të hartohet koncept-dokumenti që nuk është i vështirë të hartohet, por kërkon kohë, sepse kërkohet që disa hapa të realizohen përmes procedurave qeveritare. Tani është në Qeveri dhe së shpejti do të miratohet. Ligji, prej herës se kaluar, nga aspekti tekstual nuk besoj se do të ketë problem, nuk do të humbim kohë në pjesën tekstuale, por kur vjen te pjesa tabelore është pak subjektive, sepse çdokush ka nga një pikëpamje tjetër dhe ne duhet ta shikojmë që sa më shumë ta unifikojmë që këto pikëpamje të jenë vërejtje, së pari të shkohet prej pozitës së Presidentit e deri te pozita më e ulët dhe ta krijojmë raportin, a do të jetë 1 me 11 apo 12, pastaj cili do jetë raporti i Presidentit me Kryeministrin, pastaj Kryeministri me Kryetarin e Kuvendit, pastaj Kryetari i Kuvendit me deputetët, Kryeministri me ministra, pastaj agjencitë e ndryshme, shërbyesit civilë dhe fushat tjera, si dhe duhet ta bëjmë caktimin e vlerës së koeficientit dhe ne bazë të kësaj, ne mund të dimë se a ka me ndodh rritja e pagave apo në ndonjë pozitë edhe zvogëlimi, dhe ne ato pozita ku është mbivlerësimi i vlerës së pagave, të shohim se si mund ta kthejmë në vlerën e drejtë. Duhet ta shikojmë dhe ta rregullojmë kush mund të marrë vendimin për shtesa dhe kompensime për 80 mijë njerëzit, të cilët punojnë dhe në cilin ligj të bazohet.

Kryetarja, falënderoi ministrin për raportimin. Pra, ashtu siç thanë edhe deputetët, se në pakon e ligjeve që do ta sillni së shpejti në Kuvend, te jenë të detajuara të gjitha çështjet, sepse ne kot e bëjmë një kategorizim të pagës bazë, nëse shtesat janë ato që rregullohen me një vendim, sepse ka raste që kompensimi është më i madh se paga bazë. Po ashtu, konsideroj se pakoja me 3 ligjet duhet të vijë sa më shpejt në Kuvend dhe Komisioni për Integritet duhet të ftohet në takime, veçanërisht aty ku preket agjenda evropiane e Kosovës dhe komisioni mund të japë rekomandimet dhe imputet e tij. Pra, ne gjithsesi do t'ju ftojmë në takime tjera, për t; parë se apo përmbushet kjo kërkesë.

Ilir Deda, pasi shkoi ministri kishte vërejtje në raport dhe kërkoi që raporte të tilla në komision, mos të pranohen, sepse në këtë komision, në vazhdimësi pranohen raporte të tilla që nuk përmbajnë asgjë, andaj ne duhet ta vëmë një standard se çka kërkohet prej atyre që vijin të raportojnë, dhe nëse duhet, e bëjmë një dokument me formën sesi duhet të hartohen, sepse ky raport nuk na hyn neve në punë. Kjo nuk është vetëm e kësaj ministrie, por çdo ministri po vjen me raporte të dobëta, që janë shumë të përgjithshme. Pra, neve na duhen raporte sa më konkrete, me tabela, në mënyrë që të mund të përcjellim se sa janë duke iu afruar kërkesave që ekzistojnë. Prandaj, ne duhet ta marrim sot një vendim që mos të pranojmë raporte të tilla, dhe nëse prapë na dërgon ndonjë ministri raport të tillë, ne duhet të jemi unikë dhe mos t'i pranojmë në këtë format dhe duhet t'i dërgojnë 48 orë, para mbajtjes së mbledhjes.

Zenun Pajaziti, mendon se janë krijuar disa stereotipa të raportimeve dhe ky është kualiteti i mbikëqyrjes sonë në Kuvend, sepse shumëçka varet edhe prej nesh. Raportet janë dokumente që i nxjerr një pjesë e administratës dhe kabinetit të ministrave dhe kualiteti i mbikëqyrjes varet nëse ne insistojmë të adresojmë pyetje te duhura, nëse ne mundohemi për t'i adresuar sfidat kryesore që janë në raport me MSA-në dhe proceset integruese, atëherë ne to t'i detyrojmë ata që të japin një përgjigje dhe ne të gjithë duhet pasur një dakordim, që t'i adresojmë çështjet dhe të kemi durim, kur i bëjmë pyetje ministrit, duke ndenjur deri në fund.

Fitore Pacolli, tha se desha edhe para ministrit ta ngre këtë çështje, sepse ky nuk është raport, por vetëm një përmbledhje kot, sepse janë duke na konsideruar, si ata që nuk e njohim procesin dhe ne duhet t'i refuzojmë këto lloj raportesh, por duhet me qenë specifik, çka është kryer dhe çka jo dhe arsyeja pse nuk është kryer, sepse kjo formë e raportimit nuk është korrekte, sepse po i ikin përgjegjësisë, andaj mbetet që në të ardhmen, ne ose të definojmë saktë se çka po kërkohet në secilin raport, ose para t'i thërrasim në raportim, për të bërë një përmbledhje të kërkesave tona, që ai të përgjigjet saktë në secilën pyetje.

Armend Zemaj, kjo po duket që nuk është vetëm shqetësim i njëjtë, por vizion i përbashkët që ta nxjerrim më të mirën prej qëllimit të raportimeve të dikastereve që janë në interes të Komisionit për Integritet dhe nuk do të thotë se kur të na vijë raporti, ne të kufizohemi në raport dhe pyetjet që dolën sot ishin më tepër jashtë raportit. Ajo që duhet bërë, është që duhet adresuar paraprakisht në kërkesën tonë se çka duhet të përgjigjet ministri, atëherë e detyrojmë të japë përgjigjen e jo t'i ikë përgjigjes ose të japë përgjigjen e përgjithësuar. Ne mund të gjejmë një modalitet të përbashkët. Pajtohem si ide, por ne duhet konkretizuar, kemi mendime të ndryshme, jemi përfaqësues të ndryshëm politikë, por qëllimi është për të arritur më të mirën e mundshme për vendin tonë.

Kryetarja, tha se pajtohet plotësisht se sistematikisht kemi pasur raporte të tilla, por nëse e bëjmë në një platformë më të qartë, por ne kemi të drejtë edhe ta kthejmë raportin dhe duhet sjellë 48 orë përpara raportimit.

Zenun Pajaziti, u ndërlihd në diskutim dhe propozoi që në rastet tjera, përveç asaj që mund të adresohen më herët kërkesat tona, po ashtu mund të kërkojmë me mirëkuptim që ministri mos të na dërgojë dokument të shkruar, por duhet filluar menjëherë me pyetjet tona. Në këtë mënyrë edhe e kursejmë kohën dhe ua mundësojmë atyre të dalin më mirë para komisionit.

Ajo që na mungon neve, është se nuk ka adresim të saktë për ata që punojnë dhe për ata që nuk punojnë, ne këtu jemi në vendin e duhur, për të nxjerrë në pah ata që punojnë dhe kanë bërë progres dhe ata që nuk punojnë dhe kanë ngecje.

Në në mandatin e kaluar kemi kërkuar nga partnerët dhe shoqëria civile të tregojnë një mënyrë më të mirë se si duhet bërë mbikëqyrjen. Pra, është mirë të kërkojmë mbështetje edhe nga jashtë, për të gjetur mënyra më të mira për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve.

Lidhur me këtë çështje, në fund u vendos që stafi mbështetës i komisionit ta hartojë një formë të ngjashme, si të raportimit të PKZMSA-së, në formë tabelore, në 4 kolona, ku përfshihen dokumentet strategjike, objektivat, veprimet dhe vërejtjet apo komentet shtesë, për secilën ministri të linjës, stafi i përgatit e pastaj komisioni paraprakisht duhet të japë pëlqimin, se a pajtohen, pastaj të procedohet te secila ministri.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja, paraqiti opinionin ligjor, lidhur me projektligjin, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, duke konstatuar se dispozitat e këtij projektligji, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me Acquis të BE-së, prandaj mund të rekomandohen për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me Acquis të BE-së.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja, lidhur me projektligjin, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, paraqiti opinionin ligjor, duke konstatuar se dispozitat e këtij projektligji, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk është në

kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me Acquis të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me Acquis të BE-së.

6. Të ndryshme

Fitore Pacolli, lidhur me vizitën e fundit të komisionit, tha se ishte informuar nga mediat, andaj tha se do të ishte mirë që si kryetare e komisionit, të informojë komisionin, para se të shkojë në vizitë, për të parë se mos ne kemi qëndrime për politikën dhe diskutimet që kanë për t'u bërë dhe të raportojë për vizitën, kur të kthehen dhe kërkoi që në mbledhjen e radhës, të raportojë për vizitën e fundit.

Kryetarja, theksoi se gjithnjë e kemi informuar komisionin dhe për vizitën e fundit kemi njoftuar, por ndoshta nuk ke qenë prezent, gjithsesi ne e kemi raportin e përgatitur dhe në mbledhjen e radhës do të raportojmë lidhur me takimin që e kemi pasur në Maqedoni, në cilësinë e vëzhguesit, si Komision për Integritet Evropian.

Në vazhdim, tha se në takimin e fundit të delegacionit të lartë të BE-së, që është mbajtur në Bibliotekën Kombëtare dhe nga Komisioni për Integritet Evropian nuk ka qenë i ftuar asnjë përfaqësues.

Andaj, si kryetare, unë ia kam përcjellë znj. Apostolova, si shqetësim dhe mendoj që në takime të tilla do të duhej të kishte marrë pjesë komisioni ynë.

Fitore Pacolli, tha se me letër zyrtare mund t'i drejtohem Komisionit Evropian, për të kërkuar sqarim, pse nuk është ftuar komisioni ynë dhe të kërkojmë që çdoherë, kur ka takime të tilla të nivelit të lartë, të ftohet edhe Komisioni për Integritet Evropian.

Kryetarja u pajtua me propozimin dhe kërkoi nga anëtarët, nëse pajtohen që t'i drejtohem Komisionit Evropian, që me kërkesë të deputetes Fitore Pacolli dhe me përkrahje të komisionit, në takime të tilla, të përfshihet edhe Komisioni për Integritet Evropian, por anëtarët u pajtuan dhe kërkuan që në emër të komisionit t'i drejtohen Komisionit Evropian.

Në fund, kryetarja konstatoi se komisioni u pajtua, që me letër zyrtare, t'i drejtohen znj. Apostolova, që në takimet e ardhshme të delegacionit të lartë të Bashkimit Evropian, të ftohet edhe Komisioni për Integritet Evropian.

Përgatitur nga:
Njësia për mbështetjen e komisionit,

Kryetare e komisionit,
Blerta Deliu- Kodra
